



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2019:155543

Datë: 04.10.2024

Numri i dokumentit: 06331489

P.nr.11/2015

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtarja Dardane Ismaili, me bashkëpunëtoren profesionale Liridona Musliu Bekteshi, në lëndën penale kundër të pandehurve S.R. dhe J. D. për shkak të veprës penale: Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPRK sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.212/13 e datës 14.01.2015, duke vendosur sipas detyrës zyrtare e në mbështetje të nenit 357 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPP-së, me datë 04.10.2024 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore Mitrovicë me numër PP.II.nr.212/13 e datës 14.01.2015 dhe PUSHOHET procedura penale kundër të pandehurve:

S.R. nga i ati L..., e ëma D..., e gjinisë N..., e lindur me datë ... në Lazerovac-Serbi, me adresë të vendbanimit fshati ... Komuna e Obiliqit, me numër personal të identifikimit ..., serbe, për veprën penale:Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

J... D... nga i ati R...,e ëma E..., e gjinisë ..., i lindur me datë ... në ... Komuna e Drenasit,i martuar,ka kryer shkollën fillore, shqiptar, kosovar me numër personal të identifikimit ... për veprën penale:Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

- II. Shpenzimet e procedurës penale mbesin barrë e mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.
- III. Kërkesë pasurore juridike nuk pati.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë, ka ngritur Aktakuzën PP.II.nr.212/13 e datës 14.01.2015 kundër të pandehurve S.R. dhe J.D. për shkak të veprës penale Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së.

Gjyqtari e ka pranuar këtë lëndë më datë:02.09.2024 dhe pas ndërmarrjes së veprimeve dhe analizimit të shkresave të lëndës, konstaton se në këtë çështje ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Sipas aktakuzës, të pandehurit janë akuzuar se kanë kryer veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së për të cilën vepër është paraparë dënimi me burgim prej 3 muajve deri në (5) vjet burgim.

Neni 90 paragrafi 4 të KPRK-së, përcakton se ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar pesë (5) vjet nga kryerja e veprës penale të dënueshme me më shumë se tre (3) vite burgim. Ndërkaq, sipas nenit neni 91 paragrafi 1 të KPRK-së, përcaktohet se afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale, ndërsa sipas paragrafit 6 përcaktohet se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit.

Gjykata, nga gjitha faktet dhe provat e lart cekura konstaton se nga data vitit 2012 kur dyshohet se të pandehurit S.R. dhe J.D., kanë kryer veprën penale Legalizimi i përmbajtjes së pavërtetë nga neni 334 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së për këtë vepër penale kanë kaluar me tepër se dhjetë (10) vite, që nënkupton se duke u bazuar në dispozitën e nenit 91 paragrafi 6 të KPRK-së, në këtë rast penal ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale. Në këtë rast penal ka arritur parashkrimi absolut ngase ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit të përcaktuar me dispozitën e nenit 90 paragrafi 4 të KPRK-së.

Gjykata, konstaton se parashkrimi i ndjekjes penale është një fakt dhe rrethanë që në çdo rast sapo të vërtetohet se ekziston, Gjykata obligohet sipas ligjit ta hedh aktakuzën dhe pushoj procedurën penale. Ashtu që kjo Gjykatë, pasi ka vërtetuar se ndaj të pandehurve, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale për këtë vepër për të cilën janë akuzuar, si në dispozitiv të këtij aktvendimi, ka marr aktvendim me të cilin e ka hedhur aktakuzën si dhe ka pushuar procedurën penale ndaj tij.

Për sa i përket shpenzimeve të procedurës penale, Gjykata ka vendosur për këto shpenzime në bazë të nenit 103 paragrafi 1 të KPP-së, ku është paraparë se kur pushohet procedura penale shpenzimet e procedurës paguhen nga mjetet buxhetore, për këtë arsye edhe ka vendosur si në pikën II të dispozitivit të këtij Aktvendimi.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, sipas nenit 90 paragrafi 4 të KPRK-së, nenit 91 paragrafi 1 dhe 6 të KPRK-së e në mbështetje të nenit 334 paragrafi 1 lidhur me nenin 23 të KPRK-së KPP-së.

GJYKATA E THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm
P.nr.11/2015, datë 04.10.2024

Gjyqtarja
Dardane Ismaili

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi, palët kanë të drejt ankese në afat prej 3 ditësh, nga momenti i pranimet të Aktvendimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.